

dhe Murtezi. Gratë dhe fëmijët qëndronin në një dhomë të shtëpisë së re, përderisa burrat Zena, Haliti, Hajzeri, Murtezi dhe djali i Zenës, Avdullahu, në dhomën tjetër, nga e cila mbroheshin nga sulmet. Në mbrëmje, Zëna ka shkuar në *Mëhallën Lushaku* për të sjellë municione, por nuk ka mundur të kthehej më për shkak të përshkallëzimit të luftimeve. Ishte kjo hera e fundit kur ai i shihte të gjallë anëtarët e familjes së vet të ngushtë dhe familjarë të tjerë. Në mbrëmje, të gjithë burrat kanë rënë në betejë [5.03.1998]. U vranë edhe bashkëshortja e Halitit, Elhamja, bashkëshortja e Zenës, Bahtija, dhe dy djem të vegjël, Bujari dhe Blerimi. Djali më i madh i Zenës, Valdeti, i cili ishte i fshehur në tavanin e shtëpisë së vjetër të Halitit, i kishte parë më 7.03.1998 policët serb duke i nxjerrë trupat e së ëmës, të vëllezërve dhe të tjerëve nga shtëpia e re e Halitit. Të gjithë u varrosën më 11. 03.1998 në varrezat e *Mëhallës Jashari*.

Burimet: deklarata V.J, FDH-20309; deklarata H.J, FDH-20307; deklarata V.J, FDH-18178; KMDLNJ, *Buletini*, num. 6, janar-mars 19-98, 17-18, 130-131, FDH-23807; *Pod Lupom: Kosovo-ljudska prava u vreme oruzanih sukoba*, Buletini numër 26, FDH, Beograd, maj 1998, FDH-20114; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; SHFDUÇK, *Fenikset...*9, 41-43, 68-70, 109-111; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; FHP, penale (Radoslav Mitrović dhe të tjerë), 2.03.2009, FDH-36787.

Hamit (Hysen) Jashari

(10.10.1934, shqiptar nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Sala (Sherëmet Xhemajli) Jashari

(10.04.1943, shqiptare nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, amvise, tre fëmijë, pjesëtare e UÇK-së)

Sadik (Hysen) Jashari

(10.12.1932, shqiptar nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, dhjetë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Afije (Adem Azemi) Jashari

(1938, shqiptare nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, amvise, dhjetë fëmijë)

Hamdi (Sadik) Jashari

(1.08.1960, shqiptar nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtimor, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Elfije (Sadik) Jashari

(1963, shqiptare nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, amvise, e martuar)

Fatime (Sadik) Jashari

(1970, shqiptare nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, amvise)

Ramiz (Sadik) Jashari

(13.08.1974, shqiptar nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk)

Qerim (Hysen) Jashari

(9.10.1942, shqiptar nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, gjashtë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Hajrije (Zymer Hajdari) Jashari

(4.04.1957, shqiptare nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, gjashtë fëmijë)

Ukshin (Qerim) Jashari

(19.02.1976, shqiptar nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, pjesëtar i UÇK-së)

Shahin (Qerim) Jashari

(19.08.1973, shqiptar nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, pjesëtar i UÇK-së)

Fatime (Xhemail) Bazaj

(28.02.1978, shqiptare nga Tërsteniku/Trstenik, komuna e Gillogocit/Glogovac, amvise)

Smajl (Xhemail) Bazaj

(30.03.1980, shqiptar nga Tërsteniku/Trstenik, komuna e Gillogocit/Glogovac, bujk, një fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Shtëpitë e Hamitit, Qerimit dhe Sadikut gjendeshin njëra pranë tjetres dhe e kishin oborrin e përbashkët në *Mëhallën Jashari* [Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze]. Në datën 4.03.1998, Hamiti i ka strehuar në shtëpinë e vet refugjatët nga Tërsteniku/Trstenik [Gillogoc/Glogovac] – Fatimen, Smajlin dhe nënën e tyre Zaden [e cila u kthye në të njëjtën ditë në fshatin e vet].

Në mëngjes, më 5.03.1998, Hamiti,